



POLICY ANSWERS



Funded by
the European Union

GRANT AGREEMENT N° 101058873

HORIZON EUROPE : THIRRJE PËR APLIKIM

DEDIKUAR STAFIT AKADEMIK KËRKIMOR NË UNIVERSITETE / FAKULTETE DHE INSTITUTE E ORGANIZATA KËRKIMORE

Instituti për hulumtime zhvillimore “ RIINVEST” fton stafin kërkimor në Universitetet e akredituara në Kosovë, përkatësisht fakultetet dhe organizatat tjera kërkimore që të aplikojnë për një trajnim intensiv të mbështetur nga ky projekt që i dedikohet hartimit të propozimeve si dhe administrimit dhe menaxhimit të projekteve (përgatitjes së dosjes së aplikimit) për financimin e projekteve kërkimore në kuadër të Programit kornizë të Komisionit Evropian “Horizon Europe”. Ky Program është burimi më vëllimor dhe më i rëndësishëm i mbështetjes nga fondet e BE-së për Hapësirën Evropiane të Kërkimeve (ERA). Kosova është e inkuadruar në këtë program por pjesëmarrja e saj deri tash ka qenë thujse modeste dhe me një përqindje të ultë të aplikimeve të suksesshme (17%) dhe atë kryesisht brenda konsorciumeve që udhëhiqen nga organizata rajonale ose evropiane. Për ta tejkaluar këtë gjendje është nevojshme që të ngritën kapacitetet për përgatitjen e propozimeve përkatësisht dosjeve të aplikimit shumë cilësore sipas kërkesave specifike dhe standardeve të larta e kritereve të vlerësimit dhe zgjedhjes së projekteve.

Instituti Riinvest, si pjesë e një Konsorciumi prej 10 Institucionve kërkimore evropiane - të udhëhequr nga Qendra për Inovacione Sociale (ZSI ,Vjenë - Austri) - dhe organizatave rajonale, po implementon Projektin e financuar nga Horizon Europe - “Policy Answers” (Politka që japin përgjigje). Ky projekt katër vjeçar ka për qëllim që të zhvillojë kapacitetet në vendet e Ballkanit Perëndimor për të zhvilluar kërkimet dhe inovacionet, veçmas në fushën e Agjendës së Gjelbër, Digjitalizimit dhe Shoqërisë së shëndoshë, duke nxitur integrimin e këtyre vendeve në Hapësirën Kërkimore Evropiane (ERA), ku Horizon Europe ka një rëndësi esenciale. Në kuadër të programit të aprovuar për ndërtimin e kapaciteteve në shumë fusha, një nga aktivitetet më të rëndësishme është trajnimi i një numri kritik të punonjësve kërkimor për të përgatitur projekte cilësore dhe të suksesshme kërkimore.

Programi i trajnimit përfshin tërë ciklin e përgatitjes së projektit, përkatësisht dosjes së aplikimit që nga identifikimi i projekteve sipas thirrjes publike të Horizon Europe dhe krijimit të partneriteteve e konsorciumeve, duke përcjellë kapitujt dhe instruksionet përkatëse sipas formularëve të aplikimit dhe dokumenteve përcjellëse. Trajnimi do të përfshijë 10 ditë pune dhe do të strukturohet që të jetë stimulues e nxitës për pjesëmarrje aktive. Metodologjia e trajnimit krahas instruksioneve e ligjërimit, më tepër do të jetë e përqëndruar në punë në grupe për të mësuar duke punuar në ide dhe propozime që do të zgjedhin vetë pjesëmarrësit. Trajnimi do të përmbyllet me prezantimin e punimeve në një ngjarje që do të organizohet jashtë Prishtinës. Trajnimi do të realizohet nga ekspertë ndërkombëtarë dhe vendorë me referenca të suksesshme në trajnime dhe aplikime. Trajnimi do të mbahet në dy kohorte me gjithsej 50

pjesëmarrës. Në kohortin e parë do të përzgjidhën 25 pjesëmarrës dhe po aq për ate të dyten. Trajnimi i gurpit të parë do të zhvillohet 6-17 shkurt 2023 ndërsa i të dytit 10-21 Prill 2023 .

- Të interesuarit për pjesëmarrje në trajnim duhet të bashkëngjisin këto dokumente:
- Një letër motivimi që përfshin efektet që presin nga ky trajnim në planin individual dhe për organizatën ku punojnë.
- CV
- Listën dhe evidencën e publikimeve në revista kërkimore dhe projektet kërkimore të realizuara
- Një letër mbështetëse nga organizata ku punonjnë

Kandidatët që janë të interesuar të aplikojnë duhet të plotësojnë këto kritere:

- Të ketë të përfunduara studimet PhD, vijojnë studimet e doktoratës, ose studime master të përfunduara
- Të jenë të angazhuar në aktivitetet kërkimore në institucione akademike dhe organizata kërkimore
- Të kenë njohuri të gjuhës angleze në nivel të shkrimit akademik

Kërkesën dhe dokumentet e tjera përcjellëse duhet dorëzuar deri me 15 dhjetor 2022 përmes postës elektronike riinvest@riinvestinstitute.org.

Pjesëmarrësve në trainim u sigurohen kushtet e nevojshme teknike për punë të suksesshme duke përfshirë ushqim të lehte dhe pije freskuese.

Alban Hashani , Drejtor Ekzekutiv

Muhamet Mustafa, Udhëhqës i Projektit

